

Kthim pergjigje nr. 172 Mon 6/1/2020 10:47 AM

To: Ermela Cankaj <melwme19@gmail.com>;
Pershendetje Zj. Cankaj!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht ne Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 172, në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, sqarojmë si më poshtë vijon:

1. A u derdh e gjithë shuma e detyrueshme te të gjithë përfituesit?

Aktualisht paketat e ndihmës financiare janë në proces. Përsa i përket paketës së ndihmës ekonomike Nr. 1, janë paguar dy këste dhe gjatë qershorit pritet pagesa e kështit të tretë sipas VKM-së përkatëse. Ndërkohë për Paketën e ndihmës ekonomike Nr. 2, me VKM Nr. 423 datë 28.05.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 305 date 16.04.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19” afati për aplikim është shtyrë deri në datë 05.06.2020.

2. A ka pasur raste të cilëve iu është refuzuar përfitimi i paketës gjatë aplikimit edhe pse janë përfshirë në kategorinë përfituese? Nëse po, pse?

Ka patur raste refuzimi të pakta, për arsye teknike, për të cilat Administrata Tatimore është në proces vlerësimi ankesash.

3. A ka pasur raste që iu është aprovuar përfitimi i paketës dhe nuk iu është depozituar shuma në bankë?

Ka patur raste të tilla, për arsye se nga tatimpaguesit janë dhënë banka të cilat rezultojnë të mbyllura.

Faleminderit për mirekuptimin.

Pune te mbare

Hermelinda Hysenaj
Specialiste e Sektorit të Asistencës dhe Sherbimit
Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Tel Office : 04 2276 840

Web: www.tatime.gov.al